

## 121 MATERIALET HARTOGRAFIKE – PËRSHKRIMI FIZIK

Fusha përmban të dhëna të koduara, të cilat kanë të bëjnë me përshkrimin fizik të materialeve hartografike.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
121	Materialet hartografike – përshkrimi fizik	nr
<b>a</b>	<i>Përmasat fizike</i>	nr
<b>b</b>	<i>Imazhi hartografik parësor</i>	r
<b>c</b>	<i>Mjedisi fizik</i>	nr
<b>d</b>	<i>Teknika e krijimit</i>	nr
<b>e</b>	<i>Forma e riprodhimit</i>	nr
<b>f</b>	<i>Përshatja gjeodetike</i>	nr
<b>g</b>	<i>Forma fizike e botimit</i>	nr
<b>h</b>	<i>Lartësia e ndjesorit</i>	nr
<b>i</b>	<i>Pozicioni i ndjesorit</i>	nr
<b>j</b>	<i>Shiritat spektralë</i>	nr
<b>k</b>	<i>Cilësia e imazhit</i>	nr
<b>l</b>	<i>Mbulimi me re</i>	nr
<b>m</b>	<i>Vlera mesatare e rezolucionit të truallit</i>	nr

Në nënfushat nga a deri g vendosen të dhënat e përgjithshme, ndërsa nga nënfushat h deri m vendosen të dhënat për xhirimet nga ajri dhe xhirimet nga larg.

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 121a Përmasat fizike

Kodi tregon përmasat fizike të njësisë.

<b>a</b>	<i>dydimensionale</i>
<b>b</b>	<i>tredimensionale</i>

### 121b Imazhi hartografik parësor

Kodi tregon teknikën e përdorur për krijimin e imazhit hartografik parësor.

<b>a</b>	<i>vizatuar me dorë ose në mënyrë teknike</i>
----------	---

	P.sh. hartat e prodhuara përmes instrumenteve për vizatim, siç janë shënjesit stereo me ose pa ndihmën e kompjuterit; hartat e vizatuara ose të pikturuara me dorë.
<b>b</b>	<i>përmes fotografimit</i> P.sh. hartat e prodhuara përmes teknikave konvencionale të fotografikimit (spektër i dukshëm) siç janë fotografitë ajrore, ftohkartat, ortofotot.
<b>c</b>	<i>përmes kompjuterit</i> P.sh. hartat e shtypura me printerët e lidhur me kompjuter.
<b>d</b>	<i>me teknika ndjesore në distancë</i> P.sh. regjistrimi në distancë me radar. Përfshihen teknikat e përfshira në kodet "a", "b" dhe "c".
<b>e</b>	<i>me teknika ndjesore pasive në distancë</i> P.sh. regjistrimi në distancë me satelit MSS. Përfshihen teknikat e përfshira në kodet "a", "b" dhe "c".

Nënfusha mund të përsëritet; p.sh. ftohkartave me vizatime shtesë u vendoset kodi "b" dhe "a".

## 121c Mjedisi fizik

Kodi me dy karaktere tregon mjedisin fizik të njësisë hartografike. Karakteri i parë i kodit tregon llojin e përgjithshëm të mjedisit fizik, ndërsa karakteri i dytë llojin e materialit nga i cili është krijuar njësia (p.sh. njësia hartografike është një pllakë metalike, gur litografik, pllakë e shënuar me bazë plastike etj).

MJEDISI JOFOTOGRAFIK	
<b>aa</b>	<i>letër</i>
<b>ab</b>	<i>dru</i>
<b>ac</b>	<i>gur</i>
<b>ad</b>	<i>metal</i>
<b>ae</b>	<i>sintetikë (p.sh. plastikë, vinil)</i>
<b>af</b>	<i>lëkurë (p.sh. pergamenë)</i>
<b>ag</b>	<i>tekstil, edhe nga fibrat artificialë</i>
<b>ah</b>	<i>mjedis për ruajtje magnetike - përshtatet me kompjuterin</i>
<b>ai</b>	<i>mjedis për ruajtje magnetike - nuk përshtatet me kompjuterin</i>
<b>aj</b>	<i>letër kalk</i>
<b>ak</b>	<i>karton</i>
<b>ap</b>	<i>allçi</i>
<b>au</b>	<i>nuk dihet</i>
<b>az</b>	<i>mjedis tjetër jofotografik</i>

MJEDISI FOTOGRAFIK	
<b>ba</b>	<i>bazë pozitive elastike transparente ose jotransparente</i>
<b>bb</b>	<i>bazë negative elastike transparente ose jotransparente</i>
<b>bc</b>	<i>bazë pozitive joelastike transparente ose jotransparente</i>
<b>bd</b>	<i>bazë negative joelastike transparente ose jotransparente</i>
<b>bz</b>	<i>mjedis tjetër fotografik</i>

## 121d Teknika e krijimit

Kodi tregon hapin e fundit të teknikës së krijimit të njësisë hartografike.

<b>a</b>	<i>dorëshkrim</i> Vizatuar ose krijuar me dorë, përfshirë edhe njësitë unike si: gdhendjet në gur, modelet etj.
<b>b</b>	<i>shtyp</i> Ofset, gdhendje, shtyp me klishe në dru, litografi, stampim, Braill, relief etj. (p.sh. fotohartë e shtypur me vizatime shitesë).
<b>c</b>	<i>fotokopjim</i> Kopje në makroformë e prodhuar drejtpërdrejt në material opak me anë të energjisë rrezatuese përmes kontaktit ose projektimit (p.sh. fotohartë në letër fotografike).
<b>d</b>	<i>mikrofotografi</i> Mikrokopje në material transparent e prodhuar me anë të filmimit ose me kompjuter.
<b>u</b>	<i>nuk dihet</i>
<b>y</b>	<i>njësia hartografike nuk është produkt përfundimtar</i> Njësia nuk është produkt përfundimtar por është në mjedisin para prodhimit, siç specifikohet në nënfushën 121c – Mjedisi fizik.
<b>z</b>	<i>tjetër</i>

## 121e Forma e riprodhimit

Kodi tregon formën e riprodhimit të njësisë.

<b>a</b>	<i>me dorë</i>
<b>b</b>	<i>shtypur</i>
<b>c</b>	<i>fotografi</i>
<b>d</b>	<i>kopjim (p.sh. xerox, foto, ozalid)</i>
<b>y</b>	<i>nuk është riprodhim</i>

## 121f Përshtatja gjeodetike

Kodi tregon përshtatjen gjeodetike të njësisë.

<b>a</b>	<i>pa përshtatje</i>
<b>b</b>	<i>përshtatur por pa sistem koordinatash</i>
<b>c</b>	<i>përshtatur me sistem koordinatash</i>

## 121g Forma fizike e botimit

Kodi tregon formën fizike të botimit të njësisë.

<b>a</b>	<i>njësi e vetme</i>
<b>b</b>	<i>në pjesë</i>

	Botuar si seri, serial, botuar në pjesë.
<b>c</b>	<i>atlas</i> Përfshirë edhe atlasin me fletë të palidhura.
<b>d</b>	<i>shtojcë e veçantë e revistës, monografisë</i> Njësia hartografike është shtojcë e një seriali, monografie etj.
<b>e</b>	<i>lidhur në revistë, monografi</i> Njësia hartografike është e lidhur në brendësi të një seriali, monografie etj.
<b>z</b>	<i>tjetër</i>

## 121h Lartësia e ndjesorit

Kodi tregon lartësinë e ndjesorit.

<b>a</b>	<i>tokësor</i>
<b>b</b>	<i>ajror</i>
<b>c</b>	<i>hapësinor</i>

## 121i Pozicioni i ndjesorit

Kodi tregon pozicionin e imazhit, i cili varet nga këndvështrimi i ndjesorit kur imazhi regjistrohet për njësinë hartografike.

<b>a</b>	<i>tërthor i ulët</i>
<b>b</b>	<i>tërthor i lartë</i>
<b>c</b>	<i>vertikal</i>

## 121j Shiritat spektrale

Nënfusha plotësohet vetëm te regjistrimet në largësi. Numri i shiritave spektrale tregohet përmes një numri 2 shifror (01 deri 99). Numri është i barazuar në të djathtë, vendet e papërdorura përmbajnë zero.

## 121k Cilësia e imazhit

Kodi tregon cilësinë e imazhit.

<b>a</b>	<i>i dobët</i>
<b>b</b>	<i>i kënaqshëm</i>
<b>c</b>	<i>i mirë</i>
<b>d</b>	<i>shumë i mirë</i>

## 1211 Mbulimi me re

Një kod me numra tregon mbulimin me ren ë të tetën.

<b>1</b>	<i>mbuluar 1/8</i>
<b>2</b>	<i>mbuluar 2/8</i>
<b>3</b>	<i>mbuluar 3/8</i>
<b>4</b>	<i>mbuluar 4/8</i>
<b>5</b>	<i>mbuluar 5/8</i>
<b>6</b>	<i>mbuluar 6/8</i>
<b>7</b>	<i>mbuluar 7/8</i>
<b>8</b>	<i>mbuluar krejtësisht</i>

## 121m Vlera mesatare e rezolucionit të truallit

Nënfusha plotësohet vetëm për regjistrimet në largësi. Një kod me dy karaktere tregon vlerën mesatare të rezolucionit të truallit. Karakteri i parë përmban një vlerë numerike ose një tregues që rezolucioni është më pak se 1 cm ose më i madh se 9 km.

-	<i>më pak se 1 cm</i>
<b>1–9</b>	<i>vlerë numerike</i>
+	<i>më i madh se 9 km</i>

Karakterit tjetër përmban një kod për njësinë metrike të përdorur.

<b>c</b>	<i>centimetra</i>
<b>i</b>	<i>decimetra</i>
<b>m</b>	<i>metra</i>
<b>d</b>	<i>dekametra</i>
<b>h</b>	<i>hektometra</i>
<b>k</b>	<i>kilometra</i>

Shembuj: nëse rezolucioni mesatar i truallit është 5 cm, shënohet kodi "5c"; 80 m – "8d"; 10 km – "+k".

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

120     *MATERIALET HARTOGRAFIKE - TË DHËNA TË PËRGJITHSHME*

## SHEMBUJ

1. \*

121	□□	<b>aa caa db ga</b> (Hartë e shtypur në letër që ka dalur si botim i veçantë.)
-----	----	---

2. \*

121	□□	<b>aa caa da ga</b> ( <i>Hartë e vizatuar me dorë në letër.</i> )
-----	----	--